

NGA RECENSENTËT

Autori Fadil T. Kukleci nuk është më emër i ri në mesin e atyre që shkruajnë për bletën dhe që merren me bletari. Përpos librit të parë (Bletimi sipas metodës Kukleci) të botuar më 2007, është edhe bashkëpunëtor i rregullt i revistës “Bleta”, revistë e vetme në gjuhën shqipe në të gjitha trojet shqiptare.

Për bletën është shkruar shumë, pothuajse më shumë se për të gjitha insektet tjera. Çdo publikim i shkruar për bletën, duke marrë për bazë se kujt i dedikohet, ka specifikat e veta, kështu që edhe ky libër për të cilin do të bëhet fjalë i ka specifikat e veta.

Libri “Bletaria Bashkëkohore”, kryesisht u dedikohet bletarëve me përvojë, por edhe atyre fillestarë. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk mund ta shfrytëzojnë të gjithë ata, të cilët janë të interesuar të dinë për bletën, mënyrën e organizimit të jetës së sajë, ndërtimin anatomik dhe morfologjik, llojet e zgjojeve, teknikat e bletimit me to, sëmundjet e bletëve etj. Nga literatura që ka shfrytëzuar autori dhe përmbajtja e librit shihet se ky, përpos përvojës së vet, përshkruan edhe përvojat e të tjerëve, të arriturat shkencore, të cilat kanë ndikuar në lehtësimin dhe përmirësimin e kushteve të bletimit si dhe ngritjen e kualitetit dhe produktivitetit të produkteve të bletës.

Në këtë libër në pika të shkurtra është përshkruar historia, prejardhja dhe përhapja e bletës mjaltëse. Nga të dhënat që jepen në kaptinën e parë “Gjurmë të bletarisë Iliro – Shqiptare” del shumë qartë se bletaria në këto troje ka qenë më e zhvilluara në Ballkan.

Në kaptinën “Pozita e bletëve në botën shtazore” shihet se si bletë autoktone në këto troje është raca “*Apis mellifera carnica*” (Polm) varieteti i hirtë.

Në kaptinën e familjes së bletës shumë mirë janë dhënë të dhënat shkencore për anëtarët e familjes së bletës, shumimi dhe zhvillimi i sajë etj.

Po ashtu, edhe në kaptinën “Produktet e bletës” janë paraqitë të dhëna të bollshme për mjaltin, dyllin, propolisin, helmin e bletëve dhe qumështin e mëmave. Ajo që e bën më të veçantë këtë libër nga të tjerët është se në të përshkruhen metodat më bashkëkohore të grumbullimit të tyre e sidomos të qumështit të mëmave.

Ndërtimi morfologjik dhe anatomik është dhënë në mënyrë detale, kështu që ky tekst është i mirësearchur edhe për ata që si lëndë mësimore e mësojnë këtë lëmë.

Një risi në literaturën e bletarisë të botuar në gjuhën shqipe është se për herë të parë në këtë libër shkruhet për të gjitha tipat e zgjojeve bashkëkohore që sot janë në

përdorim siç janë: DB, LR, AZH, etj. Këtu autori jep të dhënat teknike për ndërtimin e tyre si dhe teknikat dhe metodat e bletimit për të gjitha tipet e zgjojeve që kanë rëndësi të veçantë.

Në kaptinën “ Veçoritë e bletimit në tipet e ndryshme të zgjojeve” janë dhënë detale që gjer më tani kanë munguar në literaturën shqipe, pra janë dhënë karakteristikat e bletimit në të gjitha tipat e zgjojeve dhe metodat e ndryshme që aplikohen në to.

Një rëndësi të veçantë autori i kushton kultivimit të mëmave, duke i përshkruar në hollësi procedurat e ndryshme për përfitimin e mëmave sa më cilësore, sepse siç dihet produktiviteti në bletari varet, në radhë të parë nga cilësia e mëmës. Këto metoda janë përshkruar dhe ilustruar aq qartë sa që çdo bletarë me njohuri minimale mund të arrijë rezultate të dëshirueshme

Vëmendje të posaçme autori i kushton njohurive që kanë të bëjnë me sëmundjet e bletëve dhe identifikimit të tyre, e sidomos për sëmundjet virusale.

Autori librin e ilustron me 489 fotografi (shumica prej tyre janë origjinale – të vetë autorit), të cilat e bëjnë shumë praktik.

Edhe pse asnjë libër nuk mund të jetë i përsosur, sidomos për vlerësimin kritik të recensentëve, mendoj se autori ka bërë një punë të madhe për ta realizuar një vepër të tillë. Bazuar në cilësitë e larta teorike dhe praktike, të cilat hollësisht janë mbarështruar në këtë libër „ Bletaria Bashkëkohore” iu propozoj të gjithë bletarëve si literaturë themelore dhe plotësuese në mënyrë që të bëhen bletarë të suksesshëm.

Prof. Dr. Isa R. Elezaj
Fakullteti i Shkencave Matematiko – Natyrore
Prishtinë, Kosovë

“Bletaria Bashkëkohore” i paraqitur për botim përbën një kontribut të arrirë të autorit Fadil Kukleci, duke përmbushur një kërkesë gjithnjë e në rritje si në aspektin teorik po ashtu edhe në atë praktik të të gjitha kategorive të bletarëve, të atyre që kanë pasion bletarinë, si dhe për ata që duan të mësojnë për të rejtat më të fundit në këtë fushë.

Libri i pajis lexuesit me njohuri praktike, por njëkohësisht i ndihmon të kuptojnë më mirë se çfarë është bleta dhe bletaria. Ky material i superon 519 faqe A₄ (përfshirë këtu edhe një numerik shumë të lartë skicash dhe fotografish), dhe është mjaftë i plotë nga ana formale, me pasqyrë lënde, parathënie, kapituj formues të përgjithshëm dhe specifike, si dhe pjesën thellësisht teknike të mbarështimit të bletëve dhe sëmundjet që prekin ato.

Autori që në fillim të librit ka paraqitur në mënyrë të qartë për lexuesin prejardhjen dhe përhapjen e bletës mjaltëse, po ashtu edhe sa ka të bëjë me gjurmët e bletarisë iliro-shqiptare. Në 84 faqet e para të këtij dorëshkrimi përveç historikut përshkruhen qartazi sa ka të bëjë me bletën, familjen e saj, produktet dhe anominë. Kjo pjesë është e shoqëruar me tabela foto dhe skica me sqarueshmëri shumë të lartë për nivele të studentëve të bujqësisë.

Më tej jepet shume e detajuar ajo pjesë që ka të bëjë me pajisjet e bletarit, tipat e ndryshme të zgjojeve, mënyrat e mbarështimit me to. Në këtë pjesë me shumë vlerë për bletërritësit profesionistë janë teknikat dhe moria e pajisjeve të bletarisë të cilat përdoren sipas kërkesave specifike për produkte të caktuara dhe llojeve të ndryshme të kullotave.

Po ashtu me shumë kujdes dhe me një gjuhë shumë të qartë janë paraqitur teknikat e bletimit si dhe kalendari i bletarisë, të cilat janë shumë të vlefshme si për ata që sapo fillojnë këtë aktivitet po ashtu edhe për bletarët profesionistë.

Sa ka të bëjë me mënyrat e mbarështimit të bletëve me tipat e ndryshme të zgjojeve dhe mbarështimin e mëmave është shume e kompletuar nga ana teknike dhe vjen e shoqëruar me fotografi dhe atë çfarë është shumë e rëndësishme me eksperiencën e gjatë të vetë autorit Kukleci.

Autori ka paraqitur në librin e tij mjaft fotografi origjinale të cilat demostrojnë eksperiencat e tij në bletari.

Në këtë dorëshkrim autori ka shfrytëzuar edhe një literaturë mjaftë të gjerë përfshirë 60 tekste të autorëve të huaj dhe shqiptarë si dhe një mori publikimesh shkencore, të cilat rrisin ndjeshëm vlerat shkencore dhe teknike.

Për sa me lartë vlerësoj përmbajtjen e këtij libri dhe mundin e autorit.

Në këtë këndvështrim e vlerësoj librin si një punë origjinale e me vlerë dhe mbështes plotësisht botimin e tij.

Dr. Pëllumb ALEKSI

Përgjegjës i Laboratorit të

Patologjive të Bletës dhe Molusqeve

Tel.: +355 4 2379541

Mob.: +355 682133042

e-mail: paleksi03@yahoo.co.uk

Libri “Bletaria Bashkëkohore” është libri i dytë me radhë pas atij “Bletimi sipas metodës Kukleci” (i botuar më 2007) i autorit tanimë të njohur për lëmin e bletarisë z. Fadil Kukleci. Prodhimi i ushqimit cilësor është ndër detyrat më humane të njeriut, në këtë drejtim mjalti është burim i shumë komponentëve dhe me përbërje të shumëllojshme për organizmin e njeriut dhe njëkohësisht edhe me veprim dietal dhe mjekues. Andaj kontribut të pa mohueshëm në këtë drejtim ka dhënë edhe autori Kukleci duke u ofruar kultivuesve të bletëve dhe prodhuesve të mjaltit librin “Bletaria Bashkëkohore”.

Ky libër në radhë të parë u dedikohet bletarëve, qoftë atyre fillestarë por edhe atyre me përvojë. Mirëpo përvoja e gjatë dhe njohurit e autorit në këtë lami si dhe puna shumëvjeçare e tij në arsim janë ndërlidhur shumë ngushtë në strukturimin e këtij libri dhe e bëjnë atë të shfrytëzueshëm për të gjithë ata që janë të interesuar të dinë për bletën, ndërtimin anatomik dhe morfologjik të sajë, mënyrën e organizimit të jetës, llojet e zgjojeve teknikat e bletimit etj. Madje ky libër u shërben edhe atyre që dëshirojnë të studiojnë në lëmin e bletarisë.

Literatura e konsultuar nga autor të ndryshëm, përvojat e tyre si dhe të arriturat shkencore të shfrytëzuara nga autori gjatë përgatitjes së librit e bëjnë këtë libër edhe më të veçantë.

Libri “Bletaria Bashkëkohore” përmban në vete gjithsejtë 15 kaptina të ndërlidhura shumë mirë mes veti duke filluar nga historia, prejardhja dhe përhapja e bletës dhe mjaltës pastaj pozita e bletëve në botën shtazore, anëtarët e familjes së bletës, ndërtimi morfologjik dhe anatomik, shumimi dhe zhvillimi i sajë, produktet e bletës, tipet e zgjojeve bashkëkohore që sot janë në përdorim si: DB, LR, AZH etj, pastaj veçoritë e bletimit në tipet e ndryshme të zgjojeve, kultivimi i mëmave etj.

Në fund autori u kushton rëndësi të madhe edhe njohurive që kanë të bëjnë me sëmundjet e bletëve dhe identifikimin e tyre.

Libri "Bletaria Bashkëkohore" është i begatuar me numër shumë të madh të fotografive dhe skicave, shumica prej të cilave janë origjinale të punuara nga vet autorit.

Dr. sc. Bedri S. DRAGUSHA, Prof. as.

Fakulteti i Bujqësisë, Prishtinë, Kosovë